



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 98/2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Gëzim Kokollari, Kryesues i Vendvotimit, në Ferizaj, paraqitur kundër Ilir Behluli, vëzhgues i INPOS (INPO-OJQ), në Ferizaj, për shkak të parregullsisë gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

### **VENDIM**

**Aprovohet si e bazuar ankesa** e Gëzim Kokollarit, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit, në Ferizaj ashtu që vëzhguesit të INPO-s (INPO-OJQ), Ilir Behluli i ndalohet për 3 (tre) vite të marrë pjesë si vëzhgues në zgjedhje që organizohen nën autoritetin e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), në Republikën e Kosovës.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga kryesuesi i Vendvotimit, Gëzim Kokollari, në Ferizaj, me të cilën pretendohet se vëzhguesi i INPO-OJQ, disa herë ka ndërhyrë në prezencë të votuesve dhe mënyra e ndërhyrjes ka qenë ofenduese për këshillin e Vendvotimit. Sipas parashtruesit të ankesës, ai është shpreh gojarisht në mënyrë publike me vërejtje të rrejshme, rreth prezencës së anëtarëve të VV, pa qenë prezent në VV, por nga korridori i VV, siç ka theksuar ankuesi ka ofenduar rendin, si dhe integritetin tonë individual dhe kolektiv.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

### **Ankesa është e bazuar**

Nga ankesa rrjedh se 5 (pesë) përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike i kanë vërtetuar pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë. Meqë në nenin 4. 5 të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së me Nr. 07/2009, KQZ-ja apo PZAP-i mundet me vetë iniciativë ose pas njoftimit nga Zyra ose cilido nga ZKZ-të, t'ia anuloi akreditimin cilido vëzhgues që nuk e ka respektuar Kodin e Sjelljes për vëzhguesit ose që në çfarëdo mënyre e pengon procesin e zgjedhjeve, andaj në bazë të kësaj që u tha dhe autorizimeve të PZAP-it nga nenin 115.1 të LZP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP, nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë**

A nr. 98 /2012 më datën 30.04.2012.

